

Në bazë të nenit 35, alinea 6 të Statutit Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 15.07.2007, bie këtë:

## R R E G U L L O R E

### MBI PUNËN E KOMISIONIT TË TRAJNERËVE TË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Neni 1.

Me këtë Rregullore rregullohet emërtimi, shtrirja territoriale e veprimtarisë të Komisionit të përkohshëm të Trajnerëve të basketbollit të Kosovës ( në tekstin e mëtejme: Komisioni), mënyra e punës, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit disiplinore të trajnerëve, përbërja dhe kompetencat, mënyra e vendosjes, kohëzgjatja e mandatit, përgjegjësia e Komisionit, shfrytëzimi dhe disponimi i mjeteve.

##### Neni 2.

Komisionin e zgjedh bordi i FBK-së

Kryetarin e Komisionit e emëron Bordi i FBK-së në bazë të programit të prezantuar nga radha e kandidatëve të cilët kanë parashtruar kandidaturën, e në bazë të kriterëve të hartuara nga Bordi i FBK-së.

##### Neni 3.

Komisionin e përfaqëson kryetari.

Në mungesë të tij. Kryetari e cakton personin nga përbërja e komisionit, që do ta zëvendësoi.

Kryetari përveç që e përfaqëson Komisionin kujdeset dhe përgjigjet për punën e Komisionit, zbaton vendimet e komisionit, Vendimet dhe konkluzionet e Bordit të FBK-së si dhe aktet e tjera në përputhje me dispozitat e Statutit të FBK-së.

##### Neni 4.

Mandati i komisionit zgjatë deri në çastin kur Bordi i FBK-së bie vendim mbi ndërprerjen e punës të Komisionit.

Bordi i FBK-së mund të shkarkojë Komisionin ose anëtarët e tij edhe para skadimit të mandatit në qoftë se vërtetohet se detyrat e besuara nuk i kanë kryer me përgjegjësi dhe në kundërshtim me aktet normative të FBK-së.

## II. QËLLIMET DHE VEPRIMTARIA

### Neni 5.

Komisioni është trup punues i përkohshëm i Bordit të FBK-së i zgjedhur me qëllim të përparimit, zhvillimit dhe avancimit të trajnerëve, të zgjedhjes së çështjeve organizative të TBK-së, bashkëpunimit mes trajnerëve si dhe realizimit të qëllimeve për të cilat është zgjedhur nga Bordi i FBK-së.

### Neni 6.

Veprimtaria e Komisionit.

1. Përcakton politikën e veprimtarisë së vet, harton dhe propozon planet dhe programet e punës me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të trajnerëve, dhe marrëdhënieve mes trajnerëve, si dhe bashkëpunimi me Komisionin e Gjyqtarëve të basketbollit.
2. Bashkëpunon me Këshillin Profesional të FBK në hartimin e politikave zhvillimore profesionale të basketbollit në Kosovë
3. Organizimi i seminareve dhe trajnimeve të ndryshme profesionale me qëllim të përparimit dhe aftësisë së trajnerëve.
4. Harmonizimi i veprimtarive dhe kontakteve, bashkëpunimi me shoqatat e trajnerëve nga shtetet e tjera dhe FIBA-së.
5. Përpilimi i kriterëve për licencimin e trajnerëve
6. Emërimi dhe shkarkimi i trupave punuese të Komisionit
7. Kujdesi për aftësim profesional, shëndet, mirëkuptim reciprok dhe aprovimi dhe zbatimi i vlerave morale në sport.
8. Përgatitja e punës së Kuvendit zgjedhor të SHTBK-së.
9. Dhe punë të tjera me interes të basketbollit.

### Neni 7.

Puna e Komisionit është publike. Publiciteti i punës së Komisionit realizohet me mënyrën e përcaktuar me Statutin e FBK-së.

- Me raportim të rregullt të anëtarëve lidhur me punën dhe veprimtarinë e Komisionit.
- Publikimin e vendimeve të marra.
- Publikimit në ueb faqen zyrtare të FBK-së [www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com)

### III. TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT DISCIPLINORE TË TRAJNERËVE

#### Neni 8.

Të drejtat e trajnerëve janë të përcaktuara me këto rregullore:

- Marrja pjesë në tubime të organizuara nga Komisioni (seminare, trajnime, ) etj.
- Emërimi në trupat punuese të Komisionit.
- Aftësimi profesional si dhe pjesëmarrja e obligueshme në seminare dhe trajnime, testime teorike dhe fizike.
- Zbatimi i vendimeve të komisionit dhe organeve të FBK-së
- Pagesa e anëtarësisë dhe përqindjes të përcaktuara nga Komisioni.
- Mbrojtja e autoritetit të anëtarëve.
- Ruajtja e pasurisë së FBK-së.
- Kryerja e obligimeve dhe detyrave të marra nga Komisioni dhe FBK-ja.
- Realizimi i të drejtave dhe detyrave të tjera.

#### Neni 9.

Trajnerët kanë përveç detyrave dhe të drejtave edhe përgjegjësi ndaj Komisionit. Përgjegjësia ndaj Komisionit e vlerëson dhe bie vendime Komisioni disiplinor i FBK.

Përgjegjësia disiplinore të gjyqtarëve dhe kontrollorëve në radhë të garave zyrtare të FBK-së i vlerëson dhe bie vendime Komisioni i Ligës.

#### Neni 10.

Komisioni disiplinor vendos në bazë të dispozitave të Rregullores disiplinore të FBK-së ndërsa Komisioni i Ligës në bazë të propozimeve të Garave dhe Rregullores disiplinore të FBK-së.

#### Neni 12.

Mbi vendimet e Komisionit disiplinor mund të parashtrohen ankesa. Ankesa i parashtrohet Komisionit të trajnerëve të FBK, vendimi i të cilit është përfundimtar.

Mbi vendimet e Komisionit të Ligës ankesat i parashtrohen Komisionit-Arbitrar të FBK-së, sikurse është parashikuar me Propozicionet e Garave.

#### Neni 13

Komisioni i FBK-së i përbërë nga tre (3) anëtarë të emëruar nga Bordi i FBK-së, kryen nga këto detyra:

- Harton programin e aktiviteteve të Komisionit të cilat i aprovon Bordi i FBK-së
- Zbaton politikën e zhvillimit të Trajnerëve

- Ndjek realizimin e planit dhe programit të punës duke u kujdesur për realizimin e planit dhe programit të punës duke u kujdesur për realizimin sa më të suksesshëm të tyre.
- Zgjedhë trupat punuese të Komisionit
- I propozon Bordit të FBK-së ndryshimet dhe plotësimet e planit dhe programit të punës.
- Përcakton kriteret mbi licencimin e trajnerëve dhe kategorizimin e tyre
- Harton dhe përgatit materialet ( aktet normative ) për mbajtjen e Kuvendit zgjedhor të SHGJBK-së.
- Kryen edhe punë dhe detyra të tjera të cilat ia beson Bordi i FBK-së.

#### Neni 14.

Komisioni vendos në seanca të për të gjitha çështjet nga fushë veprimtaria e tij me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Mbledhjen e Komisionit e thërret dhe udhëheq kryetari.

Kryetari thërret mbledhjen e komisionit në bazë të vlerësimit të vet, me kërkesë të Bordit të FBK-së ose më kërkesën e shumicës së trajnerëve të licencuar.

#### Neni 15.

Anëtari i Komisionit ka këto të drejta dhe obligime

- Të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit, të debatoj dhe të votojë.
- Të parashtoj propozime dhe çështje lidhur me përmbajtjen e rendit të ditës.
- Të ruaj fshehtësinë e veprimtarisë.

#### Neni 16

Komisioni mund të formojë trupa punuese ( këshilla dhe komisione) të përhershme dhe të përkohshme, vendos për kompetenca dhe emëron anëtarët e tyre.

Trupat punuese për punën e tyre i përgjigjen Komisionit.

Mandati i anëtarëve të trupave punuese zgjat sa edhe mandati i Komisionit të TBK-së.

Komisioni mund të shkarkojë trupat punuese ose anëtarin e tij edhe para skadimit të mandatit nëse vepron në kundërshtim me aktet normative të FBK-së.

### III. PASQYRA DHE AFARIZMI MATERIALO – FINANSIAR

#### Neni 17.

Pasuritë e Komisionit të TBK-së e përbëjnë:

- Mjetet financiare
- Pasuria e tundshme dhe
- Të drejtat dhe obligimet.

Neni 18.

Komisioni i TBK-së e fiton të drejtën në pasuri të tundshme dhe patundshme.

- Me pagesën e anëtarësisë.
- Me kontribut vullnetar.
- Me sigurimin e donatorëve

Neni 19.

Komisioni i TBK-së mbikëqyrë pasurit e tundshme dhe patundshme dhe atë e mbikëqyr në tërësi.

Neni 20.

Veprimtarin materialo – financiare e udhëheq arkëtari të cilin e emëron Komisioni i TBK-së.

Komisioni i TBK-së afarizmin materialo – financiar e realizon konform dispozitave të ligjeve dhe Rregulloreve tjera përkatëse të këtij lëmi të cilat aplikohen në Kosovë.

Urdhërdhënës për realizimin e këtij afarizmi janë Kryetari dhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK.

Pasuria e patundshme nuk mund të tjetërsohet pa vendimin e Bordit të FBK-së.

#### IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 21.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje i interpreton Bordi i FBK-së.

Neni 22.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrën e parashikuar për nxjerrjen e saj.

Neni 23.

Me aprovimin e kësaj Rregullore pushojnë të vlejshme të gjitha aktet normative të miratuara nga Shoqata e Trajnerëve të basketbollit të FBK-së.

Neni 24.

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e aprovimit nga ana e Bordit të FBK-së.

Kryetari i FBK-së  
Erolld Belegu